




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.376/2023

Datë: 28 korrik 2023

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe nenit 18, paragrafi 2 të Rregullores Nr. 03/2022 për Procedurën e Certifikimit, Emërimit, Kushtet, të Drejtat, Detyrimet dhe Shpërblimin e Ekspertëve Gjyqësor, në mbledhjen 313-të, të mbajtur më 28 korrik 2023, merr këtë:


V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e z. Bekim Bajrami, Ekspert për Grafologji dhe Dokumente Kontestuese, për pezullim të angazhimit si ekspert gjyqësor, për periudhën 2 (dy) vjeçare, nga data 28 korrik 2023 e deri me datë 28 korrik 2025.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 28 korrik 2023.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës me datë 26.06.2023, ka pranuar kërkesën e Bekim Bajrami, ekspert për Grafologji dhe Dokumente Kontestuese, për pezullim të përkohshëm të angazhimit si ekspert gjyqësor, për periudhën 2 (dy) vjeçare, nga data e marrjes së vendimit nga KGJK, për shkak të avancimit profesional në karrierë, duke e pasur të pamundur të ushtrij edhe detyrën e ekspertit gjyqësor.

Pas vlerësimit të kërkesës së z. Bajrami, Këshilli duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 2 të Rregullores Nr. 03/2022 për Procedurën e Certifikimit, Emërimit, Kushtet, të Drejtat, Detyrimet dhe Shpërblimin e Ekspertëve Gjyqësor, ku parashihet se “nëse eksperti gjyqësor bën kërkesë për pezullim të angazhimit si ekspert gjyqësor për një kohë të caktuar, Këshilli vendos për pezullim nga lista për aq kohë sa është kërkuar nga vet eksperti gjyqësor”, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Z. Bekim Bajrami;
- Gjykatave të Republikës së Kosovës;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.